



BASHKIA  
TIRANË  
REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK

**V E N D I M**

Nr 150, datë 09.11.2020

**“PËR**

**DHËNIEN E PËLQIMIT PËR VENDOSJEN E NJË PLLAKE INFORMUESE NË  
PËRKUJTIM TË 76-VJETORIT TË GENOCIDIT ROM” NË KRYQËZIMIN MIDIS  
BULEVARDIT “BAJRAM CURRI” DHE RRUGËS “ISUF ELEZI”**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nenit 54, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, vendimit nr. 143, datë 18.1.2012 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës paraprake (pjesa e parë + pjesa e dytë) të pronave të paluajtshme publike, shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Tiranë, të Qarkut të Tiranës” si dhe në vijim të memos nr. 25627/2, datë 21.09.2020, të Drejtorisë së Përgjithshme e Promovimit të Qytetit, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

**V E N D O S I:**

1. Të japë pëlqimin për vendosjen e një pllake informuese në përkujtim të 76-vjetorit të Genocidit Rom me vendndodhje në kryqëzimin midis bulevardit “Bajram Curri” dhe rrugës “Isuf Elezi”.
2. Vendosja e pllakës përkujtimore në vendin e përcaktuar sipas pikës 1, të këtij vendimi, shoqërohet me të gjithë dokumentacionin urbanistik të kërkuar.
3. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Promovimit të Qytetit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit për zbatimin e këtij vendimi.  
Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.

**K R Y E T A R**

**TONI GOGU**